

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit BSc në Menaxhim Turizmi

Ofruar nga Kolegji Universitar “Logos”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Ermira Qosja

Dr. Irma Shyle



Prill/2019



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc në Menaxhim Turizmi

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "Logos"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Ekonomik
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr 1055, dt 29.07.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	VKA Nr 338, datë 08.06.2012 UMASH Nr 282, datë 04.07.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në "Menaxhim Turizmi"
6	Cikli i studimit:	Cikli I parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6 (gjashtë)
16	Numri i studentëve	11 studentë
	etj	

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi

Në vitin 2000, u licensua Instituti i Formimit Profesional 'Frymë Dashurie' i cili ishte pararendës i zhvillimit të "LOGOS". Në vitin 2009, Instituti i Formimit Profesional 'Frymë Dashurie' shndërrohet në Shkollë e Lartë Private "Logos" (SHLP "Logos") me VKM Nr, 1055, datë 29.7.2009 në përbërje të së cilës kishte dy Fakultete: Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Fakultetin Ekonomik me programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor në Menaxhim Turizmi.

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Akreditimit Nr, 338, datë 8.6.2012, të shpallur me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 282, datë 04.07.2012, u akreditua programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Menaxhim Turizmi.

Pas miratimit të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë", "LOGOS" u njoh si një Kolegj Universitar jo fitimprurës me dy Fakultete: Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Fakulteti Ekonomik i përbërë nga tre departamente: Financë dhe Kontabilitet, Menaxhim Biznesi dhe Menaxhim Turizmi.

Rregullorja e programit të studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në Menaxhim Turizmi, në Fakultetin Ekonomik e Kolegjit Universitar "Logos" mbështetet në:

- Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionete arsimit të lartë".
- Udhëzimin nr. 15, datë 04.04.2008 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës "Për organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë";
- Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës nr. 134 datë 21.03.2011 "Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit të ciklit të parë të institucioneve të arsimit të lartë";
- Në Udhëzimin dhe Manualin për Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit nga APAAL,
- Statutin e Kolegjit Universitar "Logos";
- Rregulloren e Përgjithshme të Kolegjit Universitar "Logos".
- Rregulloren e Fakultetit dhe Departamentit.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Dr. Ermira Qosja
2. Dr. Irma Shyle

Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi është Specialistja e SPVC, Znj Suela Kromidha.

Më datë 09.04.2019 është dërguar nëpërmjet sistemit por edhe zyrtarisht Draft RVJ në Institucion. Më datë 23.04.2019 vjen përgjigja/komente nga Institucioni nëpërmjet sistemit por edhe zyrtarisht mbi këtë Draft. GVJ i pa me vëmendje këto komente dhe merr në konsideratë vetëm një prej tyre duke bërë ndryshim në Raportin përfundimtar.

Përgjigja e GVJ në lidhje me komentet e KUB për Draft RVJ është në fund të Raportit.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të punohet për thithjen e një kontigjenti të mjaftueshëm studentësh për realizimin me sukses të programit.
- b) Të rritet numri i pedagogëve me kohë të plotë dhe të krijohen strukturat përkatëse universitare si departamentet, qendra e vlerësimit të brendshëm, zyra e karrierës etj.
- c) Të punohet për hartimin e një metodologjie të shkruar për vlerësimin e ecurisë së programit të studimit.
- d) Të punohet më shumë për përdorimin e metodave të tërthorta të vlerësimit për tërheqjen e organizuar të vlerësimit të programeve nga vetë studentët.
- e) Të rritet kapaciteti i shërbimeve ndihmëse.
- f) Të plotësohen regjistrat dhe të instalohet një program për mbajtjen e të dhënave në sekretari.
- g) Të punohet për rritjen e vizibilitetit të Institucionit në tregun përkatës, për të rritur mundësitë për tërheqjen e studentëve me cilësorë dhe për krijimin e mundësisë për rivendosjen e kriterëve përzgjedhëse.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

a) Për rekomandimin (a), institucioni ka krijuar në vitin 2015, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe në vitin 2018 Sektorin e Marketingut (si pjesë përbërëse e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë), e gjitha kjo për përthithjen e një numri të mjaftueshëm studentësh për realizimin me sukses të programit Bachelor në Menaxhim Turizmi. Për të rritur dukshmërinë e përgjithshme të Kolegjit Universitar “LOGOS” në publik, për të rritur ndërgjegjësimin e tij për arsimin, për prezantimin e burimeve dhe shërbimeve që Kolegji Universitar “LOGOS” ofron, me miratim të Senatit (Vendim Nr.49, datë 18-04-2018) dhe Rektoratit, krijohet “Sektori i Marketingut” pranë Kolegjit Universitar “LOGOS”. **Por gjithsesi, numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit Menaxhim Turizmi për vitin akademik 2018-2019 vazhdon të jetë shumë i ulët.**

b) Për rekomandimin (b), institucioni ka krijuar qendrën e vlerësimit të brendshëm, zyrën e karrierës sikurse edhe departamentet përkatëse. Por numri i stafit akademik me kohë të plotë në departamentin e Menaxhim Turizmit është i vogël dhe kjo sipas Dekanit të Fakultetit Ekonomik është për shkak të numrit të vogël të studentëve në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi. Gjitashtu i është bërë kërkesë nga ana e Kolegjit Universitar “Logos” Ministrisë së Arsimit që të jetë e lejueshme dhe e pranueshme që numri i stafit akademik me kohë të plotë brenda departamentit të jetë më pak se 7 (shtatë), kjo duke qenë se institucioni është Kolegji.

Por gjithsesi, pranë departamentit të Menaxhim Turizmit, për vitin akademik 2018-2019, një pjesë e mirë e lëndëve të Turizmit nuk mbulohen nga staf akademik të kualifikuar në fushën e turizmit.

c) Për rekomandimin (c) Institucioni ka hartuar në vitin 2016 Metodologjinë e vlerësimit, ku jepen detaje të analizës që do të përdoret për të bërë vlerësimin e stafit akademik, stafit administrative sikurse edhe feedback-u nga studentët që kanë përfunduar studimet Bachelor pranë Kolegjit Universitar “Logos”.

d) Për rekomandimin (d) Institucioni që nga viti 2011, në funksion të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit, mësimdhënies, vlerësimit të performancës së stafit pedagogjik ka ngritur NJSBC e cila vlerëson punën në auditor të stafit akademik përmes pyetësorëve të studentëve. Synimi i NJSBC është të vlerësojë performancën e stafit akademik për mënyrën e mësimdhënies, literaturën që përdorin, metodologjinë dhe teknikat që përdorin për përcjelljen e informacionit etj. Ky vlerësim bëhet me qëllim që të evidentohen problematikat e programeve të studimit duke synuar përmirësimin e tyre. Pavarësisht punës së bërë nga NJSBC, **programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi ka nevojë për tu përshtatur me nevojat e tregut apo t’ju referohet programeve të njëjta apo të ngjashme të ofruara nga Institucionet e arsimit të lartë në vend.**

Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi në përmbajtje të tij **ka shumë lëndë të karakterit financiar dhe kontabilitet dhe jo aq sa duhet të kishte lëndë të karakterit turistik.**

Në të gjitha syllabuset e lëndëve **mungojnë detyrat e kursit**, të cilat do të ishin një vlerë e shtuar për këtë program duke angazhuar studentët që krahas njohurive teorike të marra gjatë programit, të aktivizoheshin në gjetjen apo punimin e shembujve praktikë.

Një pjesë e mirë e stafit akademik me kohë të plotë që jep lëndë të Turizmit, nuk ka përgatitjen profesionale dhe akademike në fushën e turizmit.

e) Për rekomandimin (e) Institucioni, referuar shkresës se vlerësimit të objektit datë 08.09.2016, institucioni aktualisht ka dyfishuar këtë tregues duke vënë në dispozicion një sipërfaqje të shfrytëzueshme të objektit prej 4 590 m² nga 2 860 m² në vitin 2013.

f) Për rekomandimin (f) Institucioni mban të dhënat mbi ecurinë e studenteve, realizimin e programit lëndor në rregjistra që ndodhen në sekretari. Në sekretari në formë hard-copy ndodhen: rregjistri themeltar i studentëve, rregjistri i arritjeve akademike, rregjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave, dhe rregjistri i grupit mësimor.

Për vitin akademik 2018-2019, mungonin në rregjistrin themeltar të dhënat e studentëve të rregjistruar në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi. Kolegji Universitar "Logos" ende nuk ka në përdorim Software për mbajtjen e të dhënave të studentëve.

g) Për rekomandimin (g) Institucioni ka ngritur një strukturë të veçantë të emërtuar Sektori i Marketingut si pjesë përbërëse e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë, e cila zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në Rregulloren e kësaj zyre. Gjithashtu është përgatitur Plani i Marketingut për rritjen e vizibilitetit të Institucionit në vazhdimësi dhe njohjen nga publiku të programeve të studimit që ofron. Janë realizuar fushata marketingu mbi bazën e udhëzimeve të MAS për promovimin Institucional si: "Për njohjen dhe informimin e maturantëve me Institucionet e Arsimit të lartë dhe programet e studimit të tyre", daljet me grupet e marketingut në shkollat e arsimit të mesëm në Shqipëri, spoti publicitar, Intervistat me pedagoget në radio "Ringjallja", intervistat e studenteve, fletpalosjen, nxitje dhe pjesëmarrje në aktivitetet e përbashkëta të OJF ndërkombëtare. "Dita e Ligatinave" aktiviteti i cili u promovua në faqen zyrtare dhe të facebook nga Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore e Lindore (REC), Agjensia e Zonave të Mbrojtura në Lezhë, në faqen e facebook të Universitetit etj.

Pavarësisht se Institucioni ka ngritur një strukturë të veçantë të emërtuar Sektori i Marketingut si pjesë përbërëse e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë, **numri i studentëve është i ulët por edhe me mesatare relativisht jo të lartë (më e vogël se 7.5).**

Për sa më sipër, GVJ mendon se Institucioni i ka plotësuar pjesërisht rekomandimet e dhëna nga KA në vendimin për akreditimin e parë.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Objektivi kryesor i programit “Bachelor në Menaxhim Turizmi” është t’u japë studentëve njohuritë e nevojshme bazë në fushën e menaxhim-turizmit, me qëllim formimin e specialistëve të aftë për të punuar në sektorin e turizmit si specialistë në sipërmarrjen private turistike, administratën publike në nivel qendror dhe lokal, konsulentë në fushën e turizmit dhe në menaxhimin e projekteve turistike. Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha si: njohës të potencialeve turistike (natyrore, kulturore, gjeografi turistike, histori, greqisht, anglisht), zbatuese (informatikë, statistikë), të nxitë mendimin kritik përmes aftësisimit në Menaxhim dhe të japë rekomandimet përkatëse në varësi të njohjes së legjislacionit ndërkombëtar e tregtar, etj. Sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe aftësitë që studentët fitojnë nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike, nëpërmjet vazhdimit të studimeve të ciklit të dytë, Master i Shkencave, ose Master Profesional, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.

Bazuar në rregulloren për programin e studimeve Bachelor në Menaxhim Turizmi (Korrik 2018), Departamenti Menaxhim Turizmi, si pjesë e Kolegjit Universitar “Logos” ka si mision të zhvillojë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor me qëllim që të formojë specialistë të lartë në përputhje me përparësitë strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit.

Bazuar në Vendimin e Senatit Nr. 18 datë 22.06.2007, për miratimin e Rregullores së Departamentit të Menaxhim Turizmit, programi i studimit të ciklit të parë në “Menaxhim Turizmi” synon:

- Të pajisë studentët me njohuritë bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe formimin e shprehive praktike në sektorin e turizmit. Në këtë kuadër realizohet arsimimi i lartë profesional në menaxhimin e turizmit në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.
- Të arsimojë në nivel të lartë profesional specialistë të mirëfilltë në fushën e menaxhimit të turizmit, si një degë potenciale në ekonominë e vendit tonë.
- Të përgatisë specialistë të lartë në fushën e menaxhimit të turizmit të cilët u përshtaten ndryshimeve të kohës për zhvillimin e një Turizmi të qëndrueshëm.
- Të përgatisë specialistë për Menaxhimin e Turizmit që do të kontribuojnë në përcaktimin e një modeli të suksesshem të zhvillimit të turizmit në vend. Të përgatisë njohës të mirë të të gjitha llojeve të turizmit si ai natyrorë, ekoturizmi, kulturor, argëtues etj.
- Të përgatisë specialistë të aftë për të zbatuar strategjitë dhe politikat e turizmit si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.
- Të përgatisë specialistë për të menaxhuar të gjitha sistemet e informacionit në shërbim të turizmit.
- Të përgatisë specialistë të aftë për orientimin e investimeve turistike në përputhje me zbatimin e normave ndërkombëtare turistike për realizimin e një turizmi të qëndrueshëm.
- Të përgatisë specialistë të aftë për t’u integruar me sukses në drejtimin dhe funksionimin e industrisë së udhëtimeve (agjensitë turistike, ndërmarrjet turistike, hoteleri etj).
- Të përgatisë profesionistë të gatshëm për t’ju përgjigjur ndryshimeve të tregjeve turistike në kuadër të globalizimit të ekonomisë.
- Të përgatisë specialistë për të hartuar dhe menaxhuar produkte cilësorë turistike.

Ky program synon edukimin dhe përgatitjen për tregun e punës të:

- Ekspertëve për Menaxhim Turizmin.
- Ekspertëve të turizmit në administratën publike.

- Ekspertëve të turizmit pranë OJF-ve.
- Ekspertëve të marketingut dhe komunikimit në fushën e turizmit.

Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi “ ofrohet nga Departamenti i Menaxhim Turizmi të Fakultetit Ekonomik të Kolegjit Universitar “Logos”. Programi i studimit në Menaxhim Turizmi ofrohet në ciklin e parë të studimeve dhe i referohet nivelit 6 të Komizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit është program studimi i ciklit të parë “Bachelor”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e Menaxhim Turizmit. Emërtimi i programit të studimit përputhet me fushën e arsimit të kryer.

Programi i studimit në Menaxhim Turizmi, ofrohet në gjuhën shqipe dhe forma e studimeve është me kohë të plotë.

Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit “Bachelor” në Menaxhim Turizmi është 3 vite dhe kohëzgjatja e tyre maksimale nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

Studenti që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit Universitar “Logos” (Qershor 2017).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Misioni i Kolegjit Universitar “Logos” është krijimi, zhvillimi, përcjellja dhe mbrojtja e dijeve nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, formimi i ekspertëve në fushën e turizmit, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal; ofrimin e mundësive të barabarta për të përfutur nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës si dhe integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, bazohet plotësisht në misionin e Institucionit, si edhe në strategjitë e zhvillimit të Kolegjit Universitar “Logos”.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, është hartuar duke u bazuar në tendencat strategjike të zhvillimit ekonomik të tregut në Shqipëri dhe tendencave në tregjet e huaja. Modulet e këtij programi ofrojnë njohuri në fusha të rëndësishme të tilla si: mikroekonomi, makroekonomi, menaxhimi i kompanive, menaxhim i burimeve njerëzore, financë, kontabilitet, strategji turizmi, etj.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, është në harmoni me qëllimin dhe misionin e Institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Shqipëria si një destinacion turistik gjithmmonë e me i pëlqyer dhe i vizituar nga të huajt por edhe vendasit, ka nevojë për specialistë në fushën e turizmit. Në këtë aspekt, programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është në përputhje me nevojat e tregut.</p> <p>Përmbajtja e programit tregon për një numër të larmishëm disiplinash dhe njohurish që studentët marrin gjatë tre viteve të studimit. Pavarësisht kësaj, në të duhet të kishte më tepër lëndë mësimore të fokusuar në fushën e turizmit,</p>

	pasi në program dominojnë lëndë të karakterit financiar dhe kontabilitet.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, është në përputhje me strategjinë dhe zhvillimin e institucionit duke u fokusuar tek cilësia e dijeve dhe ekspertiza e ofruar, në këtë program.
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Duke u bazuar në të dhënat mbi të ardhurat e gjeneruara nga turizmi, rezulton se turizmi konsiderohet si një prioritet dhe pikë strategjike për zhvillimin kombëtar. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, synon të edukojë ekspertë në fushën e turizmit duke u ardhur në ndihmë kompanive, institucioneve apo grupeve të interesit të fokusuar në fushën e turizmit.</p> <p><u>Institucioni nuk ka kryer studim të mirëfilltë të tregut për mundësinë e punësimit të studentëve që përfundojnë këtë program studimi</u>, për të ditur kërkesat e punëdhënësve për çfarë duhet përmirësuar apo për numrin e pritshëm që mund të regjistrohen në këtë program studimi në Kolegjin Universitar “Logos” apo në programe të njëjta apo të ngjashme në institucione të tjera.</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Kolegji Universitar “Logos” përpiket të mbajë të përditësuar programet e saj duke iu përshtatur një realiteti dinamik në ndryshim të vazhdueshëm. Programet e hartuara janë hartuar duke u bazuar në eksperiencat më të sukseshme në vend dhe jashtë vendit për të qenë sa më pranë kërkesave të tregut të punës dhe nevojave të shoqërisë.</p> <p>Në Shtator 2018 Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të Kolegjit Universitar “Logos” ka miratuar “Strategjinë e zhvillimit të Kolegjit Universitar “Logos” për periudhën 2018-2024”. Në planin strategjik në nivel institucioni, theksi vihet tek forcimi, konsolidimi si edhe përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Programet e studimit që ofrohen nga Kolegji Universitar “Logos” nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Për më tepër programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi i ofruar nga Kolegji Universitar “Logos” synon përgatitjen e ekspertëve në fushën e turizmit, për të promovuar vlerat dhe kulturën kombëtare.</p> <p><u>Programi i studimit mund të përmbante lëndë që t'i shërbenin më mirë formimit qytetar, por dhe formimit të menaxherëve të ardhshëm duke trajtuar lëndë si Sociologjia, Sjellja Organizative, Shkrimi akademik, Menaxhim Operacionesh, Menaxhim Projekti, etj</u></p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” përputhet me misionin e institucionit dhe qëllimin e tij. Ky program respekton plotësisht vlerat arsimore dhe kulturore të vendit duke u mbështetur në nevojat e tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo u konstatua pas shqyrtimit të detajuar të RVB si edhe gjithë kurrikulat përkatëse të programit Bachelor në Menaxhim Turizmi si edhe ballafaqimit me dokumentat ku shprehen misioni, qëllimet dhe strategjitë e zhvillimit të institucionit.

Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi i ofruar nga Kolegji Universitar “Logos” synon përgatitjen e ekspertëve në fushën e turizmit, për të promovuar vlerat dhe kulturën kombëtare.

GVJ arrin në përfundimin se programi BSc në Menaxhim Biznesi shfaq disa problematika, që kanë të bëjnë me: *mënyrën si ndahen kreditet në planin mësimor*; mbetet e paqartë për disa lëndë ndarja e orëve në leksion/seminar apo ushtrime, për më tepër pedagogët shprehen se pavarësisht se në disa lëndë në plan shfaqen 10 ore seminare në 15 javë, ata zhvillojnë 15; *mungesa e detyrave të kursit dhe e projekteve në planin mësimor*, ndërkohë që pedagogët shprehen se bëjnë detyra, ato nuk reflektohen në plan; *mungesa e disa lëndëve bazë formuese si shkrimi akademik apo sociologjia, mungesa e disa lëndëve të formimit karakterizues të programit* si Sjellje Organizative, Menaxhim Operacionesh, Menaxhim Projekti, Shkrim Akademik etj. shumë të rëndësishme për formimin e menaxherit.

Për sa më sipër, drejtuesit e departamenteve shprehen se janë duke punuar dhe do t'i reflektojnë në rishikimin që do t'i bëjnë programit brenda 20% të përshtatjes për vitin e ardhshëm akademik.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti Ekonomik si njësi kryesore që ofron programin e studimit “Bachelor në Menaxhim Turizmi”, përbëhet nga tre departamente: Departamenti Financë-Kontabilitetit, Departamenti Menaxhim Biznesi dhe Departamenti Menaxhim Turizmi.

Departamenti i Menaxhim Turizmi si njësi bazë që realizon programin e studimit “Bachelor në Menaxhim Turizmi” për vitin akademik 2017-2018, kishte në përbërje të tij staf akademik efektiv (me kohë të plotë) prej 7 (shtatë) anëtarësh nga të cilët 3 (tre) me tituj/grada shkencore. Numri i personelit akademik me kontratë (të jashtëm) është 2 (dy), të cilët janë me tituj/grada shkencore.

Për vitin akademik 2018-2019 (për shkak të largimeve të ndodhura), rezultojnë në përbërje të tij staf akademik efektiv (me kohë të plotë) prej 6 (gjashtë) anëtarësh nga të cilët 3 (tre) me tituj/grada shkencore.

Realizimi i planit mësimor të këtij programi dikton nevojën e bashkëpunimit me departamentet e tjera në këtë Fakultet, sidomos me Departamentit e Menaxhim Biznesit me të cilin bashkëpunon për lëndët e fushës së menaxhimit, që zëne një pjesë të konsiderushme të kurrikulës së programit të studimit “Bachelor” në Menaxhim Turizmi.

Në shkresën Nr 48, datë 10/01/2019, Rektori i Kolegjit Universitar “Logos”, ka bërë kërkesë drejtuar Ministrisë së Arsimit, për të mos plotësuar pikën 4 të Nenit 25 të Ligjit 89/2015 për numrin e personelit akademik të departamentit, pra duke kërkuar që numri i anëtarëve të departamentit të jetë më i vogël se 7. Në urdhërin e Ministrisë së Arsimit nr 29 datë 21/01/2019 urdhërohet ngritja e grupit të punës për vlerësimin e kërkesë së bërë nga Kolegji Universitar “Logos”.

Komiteti shkencor i programit të studimit “Bachelor” në Menaxhim Turizmi, përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të tre me gradë shkencore. Njëri prej tyre është ngarkuar me detyrën e koordinatorit. Koordinatori prezanton studentët me rregulloren, kriteret e pranimit, planin dhe programet mësimore, rregullat e vlerësimit, praktikës, diplomimit, etj.

Departamenti i Menaxhim Biznesi për vitin akademik 2017-2018 kishte në përbërje të tij staf akademik efektiv (me kohë të plotë) prej 7 (shtatë) anëtarësh nga të cilët 3 (tre) me tituj / grada shkencore.

Për këtë vit akademik, 2018-2019 ky Departament ka në përbërje të tij 6 (gjashtë) staf akademik të brendshëm, nga të cilët 4 (katër) me tituj/grada

Departamenti i Financë-Kontabilitetit në vitin akademik 2017-2018 përbëhej nga një staf akademik efektiv (me kohë të plotë) prej 7 (shtatë) anëtarësh, nga të cilët 3 (tre) me tituj/ grada shkencore. Numri i personelit akademik me kontratë (të jashtëm) është 2 (dy), të cilët janë me tituj/grada shkencore. Personeli administrativ në shërbim të këtij departamenti është 2 (dy).

Për këtë vit akademik, 2018-2019 ky Departament ka në përbërje të tij 6 (gjashtë) staf akademik të brendshëm, nga të cilët 2 (dy) me tituj/grada

Në Departament realizohet një ndarje sipas grup-lëndëve të mëposhtme:

1. Grup - lëndë të formimit bazë
2. Grup - lëndët e formimit menaxherial-turistikë
3. Grup - lëndët e formimit financë-kontabilitet
4. Grup - lëndët e formimit ekonomik
5. Grup - lëndët e formimit statistikë, matematikë, informatikë

Këto grup-lëndorë drejtohen nga profesorë me grada e tituj shkencorë.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Menaxhim Turizmi nuk është i plotësuar me 7 pedagogë si staf akademik, të kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore, sipas përcaktimeve të Ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë. Departamenti ka Rregulloren e tij dhe pedagogët ndahen sipas grup lëndëve, në varësi të fushave apo drejtimeve të caktuara të formimit akademik. Këshilli Shkencor i cili ka përgjegjësinë organizative për programin e studimit “Bachelor” në Menaxhim Turizmi drejtohet nga koordinatori i cili bashkëpunon me përgjegjësin e departamentit të Menaxhim Turizmi si edhe me departamentet e tjera të Fakultetit Ekonomik.

Të dhënat për përbërjen e Departamenteve në vitet akademik 2017-2018 dhe 2018-2019, gjenden në Anekse, tabela 1 dhe tabela 2.

Ngarkesa e stafit në Departament për vitin akademik 2018-2019 gjendet ne Anekse, tabela 3.

Për vitin akademik 2013-2014 dhe 2014-2015 Departamenti emërtohej Departamenti i Menaxhim Biznesit-Turizmit, ndërsa pas këtij viti, Departamenti i Menaxhim Turizmit. Të dhënat e stafit në Departament sipas viteve jepen si më poshtë:

Viti akademik 2013-2014

1 PAE (1 Prof. Dr) dhe 14 PAK (2 Prof. Dr; 4 Prof. As; 2 Dr; 6 Msc)

Viti akademik 2014-2015

6 PAE (3 Dr; 3 Msc) dhe 2 PAK (1 Prof. Dr; 1 Prof. As)

Viti akademik 2015-2016

6 PAE (2 Dr; 4 Msc) dhe 2 PAK (1 Prof. As; 1 Dr)

Viti akademik 2016-2017

7 PAE (3 Dr; 4 Msc) dhe 2 PAK (1 Prof. As; 1 Dr)

Viti akademik 2017-2018

7 PAE (4 Dr; 3 Msc) dhe 2 PAK (1 Prof. As; 1 Dr)

Viti akademik 2018-2019

6 PAE (1 Prof. Dr; 2 Dr; 3 Msc) dhe 3 PAK (1 Prof. As; 2 Dr)

Nga të dhënat e mësipërme, vërehet se vetëm për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018, është përmbushur kriteri ligjor sipas të cilët numri i stafit të brendshëm në departament duhet të jetë 7, nga të cilët tre me tituj dhe grada.

Për sa më sipër, informacion më të detajuar e gjeni në Anekse, tabela 4.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit sipas RVB jepet në tabelën 5 në Anekse. Në vizitën që ne patëm në Institucion, pedagogu P.D që në RVB është Kryetare e Këshillit Shkencor të programeve Bachelor në Menaxhim Biznesi dhe Bachelor në Menaxhim Turizmi, nuk ishte më pedagoge me kohë të plotë pranë Institucionit që nga fundviti i 2018. Që nga kjo periudhë P.D është pedagoge e ftuar (me kontratë), pranë këtij Institucioni.

Nuk kemi të dhëna për ndryshimet e bëra në Këshillin Shkencor të Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit pas largimit të P.D.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raportit PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik përbëhet nga personeli akademik efektiv dhe personeli akademik me kontratë. Ky personel ofron mësimdhënie dhe kërkimin shkencor sipas standarteve kombëtare të cilësisë të cilat janë kërkesë e vazhdueshme e Kolegjit Universitar "Logos". Personeli akademik i rekrutuar në Kolegjin Universitar "Logos" plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 dhe aktet nënligjore të dala në funksion të tij. Vendet e punës të lira për personel akademik dhe ndihmës akademik në Kolegjin Universitar "Logos" plotësohen nëpërmjet një procedure transparente e konkurruese. Kërkesa dhe nevoja për staf akademik me kohë të plotë apo të ftuar evidentohet nga Departamenti dhe më pas fillojnë procedurat për rekrutimin e stafit të nevojshëm. Përzgjedhja e kandidatit bëhet nga një komision i rekrutimit i ngritur për këtë qëllim në Departament, bazuar në dosjen e kandidatit dhe intervistën me kandidatët. Marrëdhënia e punës mes të punësuarit dhe Kolegjit Universitar "Logos" rregullohet me kontratë pune, e cila hartohet mbështetur në Kodin e Punës dhe legjisllacionin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Kontratat e punës për stafin akademik me kohë të plotë janë 1 (një) vjecare dhe mund të përsëriten në fillim të çdo viti akademik. Kontrata e punës për personelin akademik të ftuar mund të jetë për një semestër apo për një vit akademik, në varësi të ngarkesës dhe numrit të lëndëve që do të zhvillojë pedagogu pranë Kolegjit Universitar "Logos".

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Anekse,tabela 6)

Të dhënat për stafin akademik të angazhur në këtë program studimi ndër vite, paraqiten si më poshtë:

Viti akademik 2018-2019 – 19 PAE/9 PAK - Ngarkesa mbulohet në masën 68% nga PAE

19 PAE (2 Prof. Dr; 2 prof. As; 6 Dr; 9 Msc) dhe 9 PAK (1 Prof. Dr; 2 Prof. As; 6 Dr)

Viti akademik 2017-2018 – 19 PAE/2 PAK – Ngarkesa mbulohet në masën 90% nga PAE

19 PAE (1 Prof. As; 7 Dr; 11 Msc) dhe 2 PAK (1 Prof. As; 1 Dr)

Viti akademik 2016-2017 – 20 PAE/2 PAK – Ngarkesa mbulohet në masën 90% nga PAE

20 PAE (1 Prof. As; 7 Dr; 12 Msc) dhe 2 PAK (1 Prof. As; 1 Dr)

Viti akademik 2015-2016 – 16 PAE/2 PAK – Ngarkesa mbulohet në masën 88% nga PAE

16 PAE (1 Prof. As; 5 Dr; 10 Msc) dhe 2 PAK (1 Prof. As; 1 Dr)

Viti akademik 2014-2015 – 18 PAE/5 PAK – Ngarkesa mbulohet në masën 78% nga PAE

18 PAE (1 Prof. As; 6 Dr; 1 Dr në proces;10 Msc) dhe 5 PAK (2 Prof. Dr; 2 Dr; 1 Msc)

Viti akademik 2013-2014 – 4 PAE/23 PAK – Ngarkesa mbulohet në masën 14% nga PAE

4 PAE (1 Prof. Dr; 1 Dr; 2 Msc) dhe 23 PAK (4 Prof. Dr; 4 Prof. As; 4 Dr; 1 Doc; 10 Msc)

Nga të dhënat e paraqitura sa më sipër, vërehet se ndër vite programi është mbuluar në masën mbi 70% nga personel akademik i brendshëm. Përfundohet nga ky konstatim viti aktual (2018-2019) ku programi mbulohet në masën 68% nga PAE dhe viti i parë mbas akreditimit të parë të këtij programi (2013-2014) ku stafi i brendshëm ka mbuluar në masën 14% këtë program studimi.

- Të dhënat për ngarkesën mësimore për stafin akademik efektiv për vitin akademik 2018-2019, të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi jepet në Anekse në fund të tabelave.

Referuar të dhënave të marra gjatë vizitës në Institucion ngarkesa e stafit të brendshëm në këtë program studimi, për të dy semestrat, për vitin aktual akademik 2018-2019, rezultojnë minimalisht 10 orë (Prof.Dr. I.N) dhe maksimalisht 150 orë (Msc E.M)

Ngarkesa totale e stafit të brendshëm të angazhuar jo vetëm në këtë program studimi, por edhe në të gjitha programet e tjera që ofrohen nga ky Institucion, rezultojnë minimalisht 10 orë (Prof. I.N) dhe maksimalisht 195 orë për disa pedagogë (Msc E.M; Msc A.B, etj). Nuk vërehet ndonjë ngarkesë e madhe e stafit e cila mund të sillte në uljen e cilësisë së mësimdhënies. Ngarkesa totale e stafit të jashtëm të angazhuar jo vetëm në këtë program studimi, por edhe në të gjitha programet e tjera që ofrohen nga ky Institucion, rezultojnë minimalisht 30 orë (Prof.Dr. Sh.B; Prof.Asc.Dr. M.N, etj) dhe maksimalisht 120 orë (Prof. Asc. Dr. E.N; Dr. B.L, etj)

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Të dhënat sipas kualifikimeve të personelit akademik të brendshëm dhe personeli akademik me kontratë janë në Anekse, tabela 7.

- Të dhënat sipas seksit

Për vitin akademik 2018-2019, për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, janë 15 femra dhe 4 meshkuj anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë dhe për personelin akademik të ftuar janë 4 femra dhe 5 meshkuj .

Të dhëna sipas moshës së personelit jepen në Tabelën 8 në Aneks.

Këto të dhëna janë për vitin akademik 2017-2018, pasi kështu ishin të paraqitura edhe në RVB. Rezulton se personeli akademik i brendshëm është i ri dhe varion nga mosha 25-45 vjeç.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontratat e punës si për personelin akademik me kohë të plotë, ashtu edhe për personelin akademik të ftuar, kanë bazën ligjore bazuar në ligjin shqiptar të punësimit. Në kontratë pasqyrohen qartë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palëve. GVJ kërkoi në mënyrë të rastesishme tre dosje, nga ku rezultoi që mungonin kontratat për vitin akademik 2018-2019, nuk kishte aneks –kontratë dhe nuk kishte qartësi mbi ngarkesën mësimore

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në Institucion, GVJ kërkoi të dhëna për ngarkesën totale të pedagogëve të anagazhuar në këtë vit akademik në këtë program studimi, por edhe në programet e tjera të ofruara nga Kolegji Universitar Logos. Dokumentacioni që u ngarkua si fillim në sistem, paraqiste shumatoren e ngarkesës së pedagogëve të këtij programi (Semestri i parë + semestri i dytë) dhe jo ngarkesën totale të tyre. Për këtë arsye, nëpërmjet sistemit, menaxherja teknike e rikërkon ngarkesën e këtyre pedadogëve. Kjo ngarkesë është paraqitur sa më sipër.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik me kohë të plotë apo të ftuar bëhet në përputhje me procedurat ligjore si edhe në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit. Sipas personit përgjegjës të zyrës së burimeve njerëzore, procedura që ndiqet për rekrutimin e personelit akademik të ftuar fillonte me kërkesën nga departamenti me profin përkatës që duhet të kishte kandidati. Pasi bëhëj shpallja publike për personelin akademik të ftuar, dosjet e aplikantëve mblidheshin në zyrën e burimeve njerëzore dhe prej andej kalon në departamentet përkatëse të cilat bënin shqyrtimin e dosjeve. Në intervistat e bëra me kandidatët ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e departamenti si edhe Përgjegjësi i zyrës së burimeve njerëzore, të cilët bënin vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve. Lista e kandidatëve fitues, përcillej nga përgjegjësi i departamentit në Dekanat dhe prej andej tek Rektori.</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, nga ana numerike përbën 68% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi (19 PAE/9 PAK). Ndërsa ngarkesa në orë mësimore mbulohet në masën 71% nga personel akademik i brendshëm. Përgjegjësi i Departamentit, për cdo vit akademik bën vlerësimin e performancës të stafit akademik me kohë të plotë duke u bazuar në tregues të matshëm të tillë si: mësimdhënia dhe veprimtari në mbështetje të procesit mësimor; kërkimi shencor; kontributi institucional; kontributi profesional. Në bazë të këtij vlerësimi përcaktohet vazhdimësia e punësimit ose jo.</p>

	<p>Gjatë vizitës në institucion u evidentua se mungonte një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit apo të njoftimeve për punë.</p> <p>Në dosjet e personelit, kontratat e punës si për personelin akademik me kohë të plotë ashtu edhe për stafin akademik të ftuar, ishin deri për vitin akademik 2017-2018. <u>Për vitin akademik 2018-2019 mungonin kontratat si për stafin akademik me kohë të plotë ashtu edhe për stafin akademik të ftuar.</u></p>
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimit-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Sikurse edhe cilësohet në Stategjinë e zhvillimit të Kolegjit Universitar “Logos” 2018-2024 (faqja 6, paragrafi i parë), <i>Bazat e të dhënave në lidhje me personelin dhe studentin nuk digjitalizohen, gjë që kufizon mundësinë e të gjitha departamenteve dhe njësive për qasje dhe vlerësim të lehtë.</i></p> <p><i>Përveç kësaj, ASCAL ka gjetur se cilësia dhe vlerësimi standard nuk janë të organizuara siç duhet, por edhe gjatë vizitës në institucion, kishte konfuzion dhe të dhëna jo të ndryshuara në përputhje me ndryshimet e bëra në stafin akademik kohët e fundit. Psh, pedagogu P.D, në listën e vënë në dispozicion nga institucioni figuronte si PAE, ndërkohë që realisht ishte staf akademik PAK.</i></p> <p>Në faqen zyrtare web të institucionit, apo edhe në mediumet e ndryshme ku bëhej shpallja e vendeve vakante për staf akademik me kohë të plotë apo të ftuar, publikohen edhe kriteret dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik.</p>
Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimit shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimit-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Tipologjia e programit Bachelor në Menaxhim Turizmi nuk konsiston në realizimin e orëve laboratorike, për këtë arsye laboratorët nuk janë të nevojshëm. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni por edhe nga vizita që në patëm në institucion, evidentohet angazhimi maksimal i burimeve njerëzore të institucionit për përmbushjen e objektivave të programin e studimit duke vënë theksin në mësimdhënie dhe në mësimnxënie.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, ndër vite ka patur numër të vogël studentësh dhe udhëheqja dhe mbikëqyrja e studentëve gjatë praktikës mësimore ka qenë lehtësisht e menaxhueshme nga stafi akademik i Departamentit të Menaxhim Turizmit.</p> <p>Praktika mësimore për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, kryhet në vitin e tretë, në semestrin e dytë, një ditë në javë për gjatë 15 javëve të semestrit të dytë.</p>
Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimit-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Institucioni ofron mbështetje në të gjitha format, qoftë edhe financiare për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Gjatë vizitës në institucion, personi përgjegjës për zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë, sqaroi të gjitha procedurat që ndiqen nga stafi akademik për të patur mbështetjen financiare nga institucioni. Për vitin akademik 2018-2019, për departamentin e Menaxhim Turizmi, ishte në dispozicion një fond prej 600 Euro, që mund të përdorej nga stafi për pjesmarrje në aktivitete kombëtare apo ndërkombëtare në kuadër të kërkimit shkencor dhe kualifikimit të stafit akademik me kohë të plotë.</p>

	<p>Vetë Kolegji Universitar “Logos”, organizon cdo vit konferencën ndërkombëtare, në të cilën marrin pjesë me referime apo si pjesmarrës stafi akademik i departamentit por edhe studentë.</p> <p>Në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar “Logos”: https://www.eduaktiv.al/universitete/universiteti-logos-tirane, gjenden të dhënat për të gjitha programet e studimit që ofrohen.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u evidentua se mungonte një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit apo të njoftimeve për punë. Për vitin akademik 2018-2019 mungonin kontratat si për stafin akademik me kohë të plotë ashtu edhe për stafin akademik të ftuar. Gjithashtu CV e personelit akademik me kohë të plotë dhe të ftuar janë të vjetëruara (pjesa më e madhe e tyre janë CV për aplikim punësimi pranë Kolegjit Universitar “Logos”).</p> <p>Bazat e të dhënave në lidhje me personelin dhe studentin nuk digjitalizohen, gjë që kufizon mundësinë e të gjitha departamenteve dhe njësisve për qasje dhe vlerësim të lehtë. Edhe gjatë vizitës në institucion, kishte konfuzion dhe të dhëna jo të ndryshuara në përputhje me ndryshimet e bëra në stafin akademik për vitin akademik 2018-2019. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, nga ana numerike, përbën 68% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi (19 PAE/9 PAK).</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Referuar të dhënave në RVB, për infrastrukturën, konstatuam se: Objekti në përdorim nga Kolegji Universitar “Logos” është i ndërtuar me materiale cilësore dhe që plotësojnë kushtet higjeno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ duke shmangur elementët e rrezikshmërisë. Objekti siguron akustikë të mirë në ambientet e mësimi, është larg zonave të zhvillimit industrial, apo me ndotje mbi normat e lejuara sipas standardeve përkatëse. Ai plotëson në mënyrë të favorshme normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme dhe garanton kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor të studentëve, në programet e studimit Bachelor dhe Master Profesional që Fakulteti Ekonomik ofron. Lartësia e ambienteve, si dhe ndriçimi natyral i plotëson normativat teknike (sipërfaqja e dritareve mbulon më shumë se 30% të sipërfaqes së dyshemesë) dhe ndriçimi është i orientuar nga krahu i majtë i studentit.

Po sipas të dhënave në RVB por edhe të vizituar gjatë vizitës dy ditore, Institucioni ofron:

- Sipërfaqje të shfrytëzueshme të objektit rreth 4 590 m².
- Lartësia e katit mbi 3 metra dhe ndriçimi natyral i cili realizohet nëpërmjet dritareve me sipërfaqe të mëdha, te përshtatshme për auditorë.
- Burimet alternative të furnizimit me ujë nëpërmjet 4 depozitave me nga 10 ton secila.
- Burime alternative të furnizimit me energji elektrike nëpërmjet gjeneratorit.
- Sistem ngrohje qendrore me kaldajë dhe me kondicioner për të gjithë godinën.
- Hapërrirë e nevojshme për bibliotekë.
- Sipërfaqja e shfrytëzueshme në metër katror për student 7.5 m².
- Sipërfaqe e shfrytëzueshme në metër katror për person 12 m².

Institucioni disponon katër laboratorë informatike të pajisur me kompjutera bashkëkohorë që janë në shërbim të studentëve dhe zyrën e IT.

Në shërbim të studentëve është krijuar ambjent i veçantë për Bibliotekën me ambiente studimi e pajisur me literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë që ofron Kolegji

Universitar "Logos" si dhe tekste mësimore universitare që përdoren nga të gjitha universitetet e vendit. Institucioni herë pas here bën rifreskimin dhe pasurimin e bibliografisë së bibliotekës me literaturë bashkëkohore profesionale dhe enciklopedike në gjuhët shqip edhe të huaja në shërbim të studentëve. Synimi i Institucionit është që biblioteka të realizojë sigurimin e materialeve në rrugë elektronike. Biblioteka është në funksion të studentëve gjatë ditëve të javës dhe oraret e punës së saj janë të shpallura në mjediset e Institucionit.

Institucioni ka krijuar ambiente sportive kreative me ndërtimin e një palestere, të pajisur në mënyrë bashkëkohore, në përdorim të studentëve dhe pedagogëve në kohën e lirë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	4	240
Klasa për seminare	5	130
Salla për aktivitete promovuese (i shërben të dy Fakulteteve)	1	120
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	-	-
Laboratorë për lëndët	-	-
Laboratorë informatike	2	50
Salla për bibliotekën-interneti (i shërben të dy Fakulteteve)	1	100
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	20
Zyrë informacioni për studentët (i shërben të dy Fakulteteve)	1	30
Korridore/holle		175
Mjedise sportive (i shërben të dy Fakulteteve)	1	200
Mjedise shërbimi për të tretë	-	-
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	1	20
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj	1	60
Nyje hidrosanitare për studentët	4	60
Norma m²/për student	9.5	

- Mjediset për stafin:

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	1	20
Zyra për sekretarinë mësimore (i shërben të dy Fakulteteve)	1	20
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	1	60
Zyra për personelin akademik	4	110
Zyrë për financën (i shërben të dy Fakulteteve)	1	25
Zyrë për Njësinë e SBC (i shërben të dy Fakulteteve)	1	15
Salla për mbledhje (i shërben të dy Fakulteteve)	1	60
Mjedis për stafin e shërbimit (i shërben të dy Fakulteteve)	5	30
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	4	60
Ambjent për infermjerinë	1	8
Norma m²/për person		17

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Në syllabuset e lëndëve, specifikohet literatura bazë dhe literatura ndihmëse dhe Institucioni vendos në dispozicion tekstet mësimore dhe ndihmëse në ambjentet e bibliotekës. Institucioni i mundëson studentëve përdorimin e bibliotekave online dhe aksesimin në burime të tjera informacioni të formës elektronike si: Libraria e Universitetit të Pireut /Punime Masteri dhe Doktorature http:// digilib.lib.unipi.gr/dspace/ Libraria on line Questia, etj.</p> <p>Në bibliotekën e godinës qendrore janë rreth 2200 tituj të disponueshëm për pedagogët dhe studentët, në ndihmë të programeve të shkencave ekonomike.</p> <p><u>Megjithatë, në bibliotekën e institucionit, mungojnë tekste dhe botime të viteve të fundit dhe një nga synimet e Institucionit është pasurimi i bibliotekës me botime të viteve të fundit dhe të autorëve të njohur.</u></p> <p>Biblioteka e “Kolegjit Universitar Logos” është vetëm në shërbim të studentëve, të personelit mësimdhënës dhe administrativ të “Kolegjit Universitar Logos”. Frekuentimi bëhet duke iu përmbajtur Rregullores së përgjithshme të “Kolegjit Universitar Logos”. Koha e hapjes së bibliotekës është e berë publike dhe orari ndodhet në derën e bibliotekës. Biblioteka është në shërbim nga e hena në të premte nga ora 08:00 -16:00.</p> <p>Ajo është e frekuentueshme për 11 (njëmbëdhjetë) muaj të vitit, me përjashtim të Gushtit dhe pushimeve dimërore në Dhjetor.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Ambjentet e vëna në dispozicion nga Institucioni për procesin mësimor konsistojnë në klasa me hapësira të mëdha dhe të bollshme (kjo edhe për shkak të numrit të vogël të studentëve), si edhe salla konferencash të cilat janë të pajisura me kompjuter, video-projektor, ekrane të mëdha, flipcharte, multimedia.</p> <p>Sallat e leksioneve dhe të seminareve janë të pajisura me vidioprojektorë, sistem fonie, sistem kondicionimi, internet ëireless, etj.</p> <p>Laboratori i informatikës përdoret për lëndët “Informatikë” dhe për tema të veçanta në lëndë të tjera të tilla si Kontabilitet apo Financë (duke patur të instaluar programe financiare të tilla si Financë 5 apo Alpha), për të bërë të mundur një mësimdhënie sa më efektive dhe për t'u ardhur në ndihmë studentëve.</p> <p>Institucioni ka marreveshje me institucione dhe kompani të ndryshme në kuadër të praktikave mësimore që studentët e programit Bachelor në Menaxhim Turizmi kryejnë pranë këtyre subjekteve. Në strategjinë e institucionit për periudhën 2018-2024, synohet për zgjerimin e bashkëpunimeve në këtë kuadër.</p>

Konkluzione të GVJ:

Në bibliotekën e institucionit, mungojnë tekste dhe botime të viteve të fundit dhe një nga synimet e Institucionit është pasurimi i bibliotekës me botime të viteve të fundit dhe të autorëve të njohur.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**Pjesa përshkrimore**

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

GVJ Ju komunikua se KU "Logos" funksionon financiarisht dhe juridikisht brenda Fondacionit "Logos", për rrjedhojë pasqyrat financiare hartohen në nivel fondacioni. Kolegji konsideron pozitive mbështetjen nga një fondacion jofitimprures, që sipas përfaqësuesve reflektohet tek tarifa e studimit relativisht e ulët krahasuar me Institucione të tjera (150.000 Lekë) por edhe një sërë politikash pro-studentit.

Burimet e të ardhurave janë: tarifat e studimit, financimi i vazhdueshëm i fondacionit "Logos", financime dhe donacione të tjera nga organizata ose individë të ndryshëm në përputhje me ligjet në fuqi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi.

Të dhënat e mëposhtme i referohen nga RVB të Kolegjit si programit Bsc Menaxhim- Biznesi, ashtu dhe programit Bsc Menaxhim Turizmi.

Të ardhurat nga:	Viti 2012-2013	Viti 2013-2014	Viti 2014-2015	Viti 2015-2016	Viti 2016-2017	Viti 2017-2018
Pushteti qendror						
Pushteti vendor						
Fonde jopublike:	10.956.400	11.599.207	17.654.810	19.508.555	20.317.591	15.802.700
Grantet për kërkim dhe kontratat						
Konsulencat, shërbimet						
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	150.000	150.000	150.000	150.000	150.00	150.000
Sponsorizimet						
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)						

Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj	3.487.957	8.041.000	8.938.816	5.180.000	11.110.478	11.358.916
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)						
SHUMA	14.444.357	19.640.207	26.593.626	24.688.555	31.428.069	27.161.616

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik.

Kostoja e studimit për një student në këtë program studimi për vitin akademik 2017-2018 rezulton të jetë 250.000 Lekë.

Në zërin e shpenzimeve për llogaritjen e koston për student janë përfshirë vetëm shpenzimet operative të KU "Logos" (Paga, personeli, sigurimet shoqërore, energji, ujë, telefon, shpenzime kancelarie, etj.) Shpenzimet për investime kapitale (zgjerim i sipërfaqes së shfrytëzueshme, palestra, pajisjet laboratorike) mbulohen nga Fondacioni "Logos". Në llogaritjen e koston për student nuk janë marrë parasysh shpenzimet për investime kapitale.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Kontrolli dhe auditimi në Kolegjin Universitar "Logos" realizohet nga Zyra e Auditit, e cila funksionon pranë Departamentit Financiar të Fondacionit "Logos", i cili është edhe financuesi kiyesor i Kolegjit Universitar "Logos". Veprimtaria e kësaj njësie dhe funksionimi i saj bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rezultatet e auditimit i bëhen të ditur Bordit të Fondacionit dhe atij Administrativ. Aktualisht KU "Logos" nuk ka të ardhura nga grante të huaja apo kontrata shërbimesh.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p>	<p>Institucioni harton bilancin financiar, i cili përmban pasqyra të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontribute të tjera financiare. Raporti financiar me të dhënat e hollësishme financiare të të</p>

<p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>ardhurave për Institucionin, disponohet nga Zyra e Financës.</p> <p>Donacionet për Kolegjin Universitar “Logos” kanë patur tendencën e rritjes nga viti 2012 deri në vitin 2018 dhe fondet jo publike gjithashtu janë rritur deri në vitin 2017, duke pësuar një rënie në vitin 2018.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Fondacioni “Logos” harton dhe administron pasqyrat financiare për KU “Logos” si dhe kostot e programit të studimit.</p> <p>Kolegji dëshmon për shkak të donacioneve qëndrueshmëri financiare, por është i ndërgjegjshëm që duhet më shumë përpjekje institucionale për t’u bërë pjesë e projekteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u takua edhe me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë. Sipas përfaqësuesve të kësaj zyre, GVJ Ju komunikua se:

- Senati Akademik i KU “Logos” me vendimin Nr.43, datë 08.02.2018, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në përputhje me Ligjin 80/2015.
- Gjithashtu, Senati Akademik në zbatim të kërkesave të Ligjit 80/2015 ka ngritur Komisionin e Përhershëm për vlerësimin institucional, i cili harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë të shprehura këto në Statutin e Kolegjit Universitar “Logos”.

NJSBC ka akses në të gjithë informacionin e institucionit duke mundësuar që në bazë të politikave dhe kriterëve kjo njësi të bëjë sugjerimet apo vlerësimet e përshtatshme për të garantuar sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njësia është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit dhe ka për detyrë paraqitjen e Raportit Vjetor për Institucionin ku përfshihen dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimeve akademiko- administrative të ofruara si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen. Raporti i paraqitet Senatit Akademik, miratohet dhe publikohet. Funksionet dhe detyrat e NJSBC janë të parashikuara në Statut, Rregullore të Brendshme dhe Rregulloret specifike të Kolegjit Universitar “Logos”.

Kjo njësi në bashkëpunim me Komisionin për vlerësimin institucional harton politikat për vetëvlerësim, përcakton kriteret e vlerësimit, harton anketimet dhe modelet e raporteve vlerësuese.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Për vitin akademik 2017-2018 janë realizuar 2 anketime (një në semestrin e parë dhe një në semestrin e dytë). Në anketim kishin marrë pjesë 14 studentët të programit të studimit “Bachelor” në Menaxhim Turizmi. Nga NJSBC na u bë e ditur se ishin përpunuar të gjithë formularët e plotësuar. Përgjatë procesit nuk kishte patur

problematika. Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i NJSBC-së kishte vendosur që për pedagogët me koeficientë vlerësimi më të vogël se 4 të bëhej shikimi i regjistrave edhe të evidentohet ndonjë parregullsi në lidhje me temat dhe datat e paraqitura. Gjithashtu të krahasoheshin këto tema me ato të paraqitura në syllabuset e dorëzuara në departament.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

NJSBC është përgjegjëse për ruajtjen, nxitjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë brenda institucionit. Ajo bashkëpunon me njësitë bazë nëpërmjet grupeve të sigurimit të cilësisë të ngritura në nivel Departamenti. Njësia është në varësi direkte nga Rektori i Kolegjit Universitar "Logos".

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Tabela 9 në Aneks)

NJSBC funksionon që nga nivelet bazë (Departamentet), kështu në nivel të njesisë bazë në fillim të vitit akademik, gjatë procesit të mësimdhënies dhe në përfundim të tij analizohen dhe vlerësohen programet, literatura, forma dhe metodat didaktike të mësimdhënies, format e vlerësimit.

Kontrolli dhe përfundimet nxirren në bazë të të dhënave statistikore të grumbulluara, raporteve të vetvlerësimit të punonjësve akademik, raporteve semestrale dhe vjetore të marra nga njësitë bazë si dhe nga rezultatet e arritura nga studentët. Të gjitha këto të dhëna që merr në dispozicion NJSBC i shërbejnë për të analizuar gjithë procesin akademik për programin e studimit të ofruar nga njësia bazë dhe në këto kushte ai rekomandon përmirësime në proces.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

NJSBC-ja ka punuar në drejtim të anketimeve të kryera me studentët duke analizuar problematikat dhe duke nxjerrë detyrat për të ardhmen.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Politikat e përmirësimit të cilësisë parashikohen në planin strategjik të zhvillimit institucional ku theksohet që pasaporta e një universiteti modern për njohjen sociale dhe dallimin ndërkombëtar është përsosmëria akademike. Kjo mund të arrihet vetëm nëse të gjitha pjesët përbërëse, p.sh. stafi akademik dhe administrativ, punojnë shumë brenda një strukture të shëndoshë organizative. Mjeti kryesor për të siguruar këtë është një sistem i brendshëm i përhershëm i sigurimit të cilësisë bazuar në standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Fakulteti i Ekonomisë, përdor metodologji vlerësimi, dhe instrumente matëse dhe vlerësuese në formën e intervistave dhe pyetësorëve për ecurinë e programeve të studimeve.
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;	Vlerësimi bëhet për aspektet e: performancës së stafit akademik, realizimit të planit mësimor, statistika të
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	

<p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj. 	<p>kalueshmërisë dhe nivelit të studentëve si edhe të dhëna mbi përputhshmërinë e punësimit me diplomën Bachelor në Menaxhim Turizmi etj.</p> <p>Metodat për vlerësimin që përdoren nga Kolegji Universitar “Logos” janë:</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Pyetësorë të studentëve që ndjekin programet e studimeve Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies Pyetje konceptuale; Intervista Vlerësim i performancës së stafit akademik <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Dëgjime në auditor Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës;
<p>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</p> <p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Kolegji Universitar “Logos” është vlerësuar nga ASCAL në bashkëpunim me QAA për akreditimin institucional për një periudhë 3 vjetecare, me vendimin Nr 95 të Bordit të Akreditimit, dt. 20/10/2017.</p> <p>Kolegji Universitar “Logos” harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre, përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit. Përfaqësuesit e institucionit u shprehën gjatë vizitës, se janë pikërisht këto metodologji dhe instrumenta vlerësimi që kanë përcaktuar dhe gjithë ndryshimet e nevojshme që KU përgatitet të bëjë për vitin 2019-2020.</p> <p>Institucioni ka një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik, çdo vit, nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve në çdo fund semestri. Programet e studimeve dhe syllabus-et rishikohen çdo fillim viti akademik, me pjesëmarrjen e grupeve të sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë. Theksi vihet në përditësimin me literaturë bashkëkohore, ndryshimet në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Kjo realizohet në bashkëpunim me Senatin Akademik dhe Drejtuesit e njësive bazë e kryesore.</p> <p>Institucioni synon ndërgjegjësimin e stafit akademik dhe të studentëve, për rëndësinë e cilësisë dhe</p>

	<p>sigurimin e cilësisë, duke organizuar seminare, takime apo diskutime në lidhje me cilësinë dhe përmirësimin e saj.</p> <p>Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar në Planin Strategjik të Institucionit.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Duke u bazuar në RVB por edhe në takimin dhe intervistën që patëm me anëtarët e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm pranë Kolegjit Universitar “Logos” arrijmë në konkluzionet:

Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve. Përfaqësuesit e institucionit u shprehën gjatë vizitës, se bazuar në këto metodologji dhe instrumenta vlerësimi janë përcaktuar gjithë ndryshimet e nevojshme që Kolegji Universitar përgatitet të bëjë për vitin 2019-2020.

Në faqen zyrtare web të Institucionit nuk u gjetën publikime të informacioneve për vlerësimin e brendshëm. Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është i atashuar pranë Fakultetit të Ekonomisë, Departamentit të Menaxhim Turizmi.

Kohëzgjatja e programit të studimeve Bachelor në Menaxhim Turizmi është 3 vjet/6 semestra forma e studimit është, studime me kohe të plotë dhe studentët për t’u diplomuar duhet të realizojnë 180 kredite. Në përfundim të programit, studentët pajisen me diplomë: Bachelor në Menaxhim Turizmi.

Ky program studimi është hartuar duke u bazuar në tendencat strategjike të zhvillimit ekonomik në tregun shqiptar dhe tendencave të tregjeve të huaja duke ofruar module me karakter të mirëfilltë teorik dhe praktik, që ofrojnë njohuri nga fusha e menaxhimit, marketingut, financës, kontabilitetit dhe turizmit. Misioni i Programit të Studimit të ciklit të parë Bachelor në Menaxhim Turizmi, është të sigurojë arsimim cilësor universitar dhe të ofrojë formim specifik në menaxhimin e turizmit. Për përmbushjen e këtij misioni, programi ofron përgatitje dhe diplomim të studentëve në nje spekter nderdisiplinor njohurish, duke synuar aftësimin e studentëve për të kontribuar si në sektorin publik ashtu edhe atë privat.

Qëllimi i programit është të ofrojë njohuri në disa fusha duke mundësuar formimin akademik dhe të përgatisë profesionistë në fushën e menaxhimit të turizmit. Objektivi i programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, është tu ofrojë studentëve jo vetëm njohuri akademike por edhe formim në aspektin praktik të menaxhimit të turizmit, nëpërmjet praktikës profesionale. Pas përfundimit të programit të studimit, studentët do të jenë në gjendje të punojnë si ekspertë në fushën e menaxhimit të turizmit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi ka filluar në vitin akademik 2009-2010. Forma e studimit është me kohë të plotë dhe kohëzgjatja është 3 (tre) vite akademike pra në 6 (gjashtë) semestra. Ky program

ka 180 ECTS. Në përfundim të programit të studimit, studentët pajisen me diplomë Bachelor në Menaxhim Turizmi. Duhet thënë që programi i studimit në Menaxhim Turizmi, pas daljes së vendimit Nr. 41, dt 24.01.2018, është rikategorizuar nga 6 disiplina në 5 pesë. Deri para daljes së këtij Vendimi ndarja e lëndëve bëhej si veprimtarive nga A në F (*Shiko Aneks, tabela 10*)

- Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë etj.)
 - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
 - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
 - 1orë mësimore- 50 minuta

 - Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela 11 në Aneks)

 - Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit (Tabela 12 në Aneks)
 - Leksionet 10 ore ne auditor dhe 15 ore pune e pavarur e studentit
 - Seminaret 10 ore ne auditor dhe 15 ore pune e pavarur e studentit
 - Praktiken Profesionale 30 ore ne auditor dhe 120 ore pune e pavarur e studentit
 - Provimi perfundimtar 5 ore ne auditor dhe 20 ore pune e pavarur e studentit

 - Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 13 ne Aneks)

Nga fillimi i ofrimit të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi e deri tani, vihet re një ndryshim i madh në përmbajtjen e programit, në heqje dhe futje lëndësh, apo edhe ndryshime në kredite. Kështu, lënda Etikë komunikimi i biznesit në vitin 2011 u hoq nga programi, dhe në vitin 2014 u ndryshua si lëndë me 2 ECTS.

Lënda Sjellje organizative u shtua në programin e studimit në vitin 2011 dhe në vitin 2014 u hoq nga programi. GVJ në opinionin e tij e konsideron të rëndësishëm këtë lëndë për programin e studimit.

Lënda Shërbimi i pritjes në vitin 2010 ishte më 3 ETCS dhe në vitin 2011 u hoq nga programi. GVJ e konsideron këtë lëndë të rëndësishme për profilin e studimit.

Përmirësime në program GVJ konsideron futjen e disa lëndëve të rëndësishme të tilla si Turizmi ndërkombëtar që në vitin 2011 ishte me 5 ETCS dhe në vitin 2014 u ndryshua në 6 ETCS. Gjithashtu e ndryshim pozitiv konsiderohet nga GVJ edhe ndryshimi i krediteve të praktikës profesionale që u shtua në 2011 me numër kreditesh 4 ECTS dhe u ndryshua numri i krediteve në 2014 në 7 ECTS etj.

 - Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 14 në Aneks)

 - Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset nuk specifikojnë ndarjen e krediteve midis leksioneve, seminareve (apo edhe laboratoreve për lëndët që kanë laboratore). Në syllabuse nuk specifkohet tipologjia e lëndës, sikurse edhe lloji i lëndës nëse është e detyrueshme apo me zgjedhje. Në të gjithë syllabuset mungojnë përcaktimi i orëve sipas tematikave të leksionit pasi paraqiten vetëm tematikat që trajtohen gjatë leksioneve. Në të gjitha syllabuset mungojnë tematikat e trajtuara në seminare me përkatësisht orët për secilën tematikë.

Një model syllabusi për programin e studimit Menaxhim Turizmi është syllabusi për lëndën Bazat e Marketingut (Tabela 15 në Aneks).

 - Analizë e cilësisë së syllabuseve
- GVJ nga kqyrja e të gjitha syllabuseve të lëndëve evidentoi se formati i tyre është në përputhje me VKM Nr 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”,

Shtojca Nr 2. Megjithatë GVJ konstaton se mungesa e detyrës së kursit në silabuse është evidente në të gjitha lëndët, duke ndikuar drejtpërdrejt në formimin e studentit, të cilit krahas njohurive i duhet të të fitojë dhe aftësi praktike.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Akreditimi i parë i programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është bërë në vitin 2012. Programet e studimit të ofruara nga Kolegji Universitar “Logos” janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi ka 180 kredite, të ndara në 3 vite akademike, pra sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Departamenti i Menaxhim Turizmit pranë Fakultetit Ekonomik, është njësi kryesore dhe përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi. Të dhënat në lidhje me përmbajtjen e këtij programi studimi si edhe të gjithë programeve të studimit që ofron Kolegji Universitar “Logos” janë bërë publike edhe në faqen zyrtare të institucionit në internet. Në përmbajtjen e programit të studimit përkatës, specifikohet edhe tipologjia e secilës lëndë duke specifikuar nëse është lëndë e detyrueshme apo me zgjedhje sikurse edhe ndarja e krediteve përkatësisht në leksione dhe seminare.</p> <p>Në fillim të çdo semestri, pedagogët përkatës së lëndëve, u vendosin në dispozicion studentëve syllabuset e lëndëve, duke i njohur ata në këtë mënyrë edhe me detyrimet përkatëse të lëndës apo mënyrën e vlerësimit.</p> <p>Para fillimit të vitit akademik, në departament bëhet parashikimi i ngarkesës së stafit akademik me kohë të plotë, duke bërë në këtë mënyrë edhe parashikimin për staf akademik të ftuar për të plotësuar nevojat e departamentit në fushën e mësimdhënies.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, programi është ri-strukturuar në vitin e fundit në 5 kategori lëndësh. Programi karakterizohet nga një numër i madh i lëndëve të karakterit financiar dhe kontabilitet, gjë që pranohet dhe nga vetë drejtuesit dhe pedagogët e departamentit.</p> <p>Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</p> <p>Syllabuset ishin përshtatur sipas VKM Nr 41, datë 24.01.2018. GVJ sygjeron se në syllabuse duhet të shtohen detyrat e kursit me kredite përkatëse.</p>	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Format kryesore të procesit mësimor në programin e studimit *Bachelor* në Menaxhim Turizmi në Fakultetin e Ekonomisë në Kolegjin Universitar “Logos” janë: leksionet, seminarët dhe praktikat mësimore.

Semestri i gjashtë (viti i tretë) në programin e studimit *Bachelor* në Menaxhim Turizmi, i është rezervuar praktikës profesionale (1 ditë në javë për 15 javë të semestrit) dhe përgatitjes së tezës (këtë vit akademik është vendosur që studentët të ushtrohen provimit në vend të tezës së diplomës)

Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bërë konform Udhëzimeve të marra nga Ministria Arsimit dhe Shkencës, në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë VKM 41, datë 24.01.2018 duke i grupuar lëndët në disiplina nga A-E. Lëndët klasifikohen në dy grupe: të detyruara dhe me zgjedhje.

Në programin e studimit Bachelor “Menaxhim Turizmi” procesi i mësimdhënies për çdo lëndë apo modul zbatohet sipas syllabus-it të miratuar në fillim të vitit akademik i cili është hartuar në liri të plotë akademike nga personeli që e ofron këtë lëndë apo modul gjatë vitit akademik.

Kolegji Universitar “Logos” i kushton një rëndësi të veçantë përzgjedhjes së stafit akademik, duke synuar përputhjen e interesave të tyre me programet që ofrohen. Duke plotësuar të gjitha standartet e parashikuara në legjislacionin shqiptar në lidhje me numrin e stafit akademik për çdo department, Kolegji Universitar “Logos” ka punësuar edhe staf me kohë të pjesshme i cili angazhohet në disa fusha. Gjithsesi, aktualisht përqindja e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, të mbuluar nga stafi me kohë të plotë është më pak se 70%.

Departamenti, në bazë të kurrikulës i paraqet çdo anëtar i stafit akademik formatin bazë të syllabus-it të përdorur nga Institucioni, ku përfshihen të gjitha detajet në lidhje me mbarëvajtjen e zhvillimit të lëndës. Pedagogu diskuton tematikat apo ndryshimet e mundshme në syllabus, ku përfshihen në mënyrë të detajuar të secilës lëndë: qëllimi i lëndës, objektivat, bibliografia e detyrueshme, bibliografinë e rekomanduar etj. Dosja me karakteristikat e çdo lëndë studjohet në nivel departamenti dhe pasi shihet se është në përputhje me modelin e fakultetit dhe departamentit, merr miratimin e tij.

Është e detyrueshme që nga ana e çdo pedagogu të përgatitet “dosja e lëndës” e cila përfshin të gjitha materialet dhe leksionet e shpjeguara gjatë semestrit, si një kopje shembull të provimeve të zhvilluara, etj. Mjetet didaktike të përdorura për mësimdhënie janë tabela, kompjuteri, projektori etj.

Elementët e vlerësimit për secilin student, që janë të specifikuar në secilin nga syllabus-et e lëndëve, dokumentohen nga pedagogu i lëndës dhe i bashkangjiten fletës së provimit. Procesverbalet e provimit plotësohen vetëm pasi i është dhënë mundësia çdo student për ankimim apo rishikim të provimit të bërë prej tij, kjo bazuar në rregulloren e programit të studimit.

Departamenti analizon të dhënat e anketimeve të zhvilluara me student për cilësinë e mësimdhënies, në të gjithë komponentët e saj dhe ndërmerr hapa për përmirësim të kurrikulës dhe të stafit akademik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet bazuar në RVB jepet si më poshtë:

Programi i Studimit "Bachelor" në Menaxhim Turizmi	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	815
Seminare	855
Ushtrime	-
Laboratore	-
Praktikë lëndore	-
Praktikë profesionale	140
Diploma	24
Në total	1834

Në fakt, në RVB ka konfuzion në lidhje me të dhënat për orët në auditor sipas krediteve të lëksioneve, seminareve, diplomës dhe praktikës profesionale. Në planin mësimor të paraqitur në RVB, orët në auditor për leksionet janë 834 orë, seminarët (830 orë) + praktika (140 orë)+diploma (30 orë), që në total janë 1835 orë në auditor.

Ndërkohë që po në RVB, sqarohet ndarja e orëve sipas krediteve duke përcaktuar që për praktikën mësimore orët në auditor janë 30 orë dhe 120 orë jashtë auditorit. Ndërkohë që praktika ka 7 kredite dhe numri i orëve në auditor duhet të ishte 210 orë dhe jo 140 orë.

Edhe në dokumentacionin e kërkuar nga GVJ gjatë vizitës në institucion në lidhje me planin mësimor të programit Bachelor në Menaxhim Turizmi ka konfuzion në të dhëna. Kështu Leksionet sipas këtij dokumenti janë 890 orë në auditor, Seminarët 570 orë, Ushtrime 150 orë, Laboratore 60 orë, Diploma 24 orë dhe Praktika profesionale 140 orë, që në total janë 1834 orë në auditor.

Format e kontrollit të njohurive

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash.

Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit detyrimisht kthehet në notë.

Shkalla e përvetësimit të dijeve bëhet me sistemin e vlerësimit me pikë (nga 0 deri në 100), të cilat konvertohen në notë. Nota më e ulët kaluese është 5 (pesë), ndërsa më e larta 10 (dhjetë). Katra (4) është notë jokaluese.

Pedagogu vlerëson pjesëmarrjen e studentëve në diskutime gjatë seminareve duke mbajtur shënimet përkatëse.

Në vendosjen e notës përfundimtare merren parasysh frekuentimi, vlerësimi përgjatë semestrit dhe testi i dijeve. Nota shënohet me numër dhe me tekst në Procesverbalin e provimit.

Vlerësimi përfundimtar (semestral) do të bazohet në:

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	-
Testimet gjatë vitit	30%
Provimi përfundimtar	60%
Etj	-
Në total	100%

Provimi i përgjithshëm përfundimtar/mbrojtje diplomës Bachelor zhvillohet në fund të semestrit të dytë të vitit të tretë, pas procesit mësimor por bazuar në takimin me Dekanin e Fakulteti Ekonomik, për vitin akademik 2018-2019 do të organizohet provim përfundimtar në vend të punimit të tezës së diplomës)

Shkalla e përvetësimit të dijeve bëhet me sistemin e integruar të vlerësimit:

- Me pikë nga 0 deri në 100 pikë.
- Me notë: rezultati përfundimtar i pikëve konvertohet në notë nga nota 4 (katër) në notën 10 (dhjetë), sipas tabelës së mëposhtme:

Pikët	1-44	45-54	55-64	65-74	75-84	85-94	Mbi 95
Nota	4	5	6	7	8	9	10

Studenti i përfiton kreditet e disiplinës përkatëse në rast vlerësimi pozitiv në atë disiplinë.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë (Tabela 16 në aneks)

Në grupin e punës për vlerësimin e brendshëm-1 student

Në grupin e punës për sigurimin e brendshëm të cilësisë -1 student

Në projekte shkencore të organizuara nga Fakulteti Ekonomik-3 studentë

Studentët marrin pjesë edhe në konferencën e përvitshme të organizuar nga Kolegji Universitar "Logos" si pjesëmarrës, autorë të parë ose bashkëautor në punime shkencore.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi i studentëve në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi bëhet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin, Rregulloren dhe Strategjinë e KU "Logos". Kështu, pranimi në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Menaxhim Turizmi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave; që zotëron një diplomë të lëshuar nga një Institucion i Arsimit të Lartë brenda vendit dhe jashtë vendit; që zotëron një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me diplomën e maturës shtetërore

Forma e studimit në ciklin e parë është me kohë të plotë dhe frekuentimi është i detyrueshëm në masën 75%. Afati maksimal i përfundimit të studimeve është sa dyfishi afatit të rregullt. Studenti mund të rregjistrohet në vitin pasardhës kur ka fituar 50% të ECTS të vitit paraardhës. Lëndët që u përkasin krediteve të mbetura, konsiderohen detyrime të mbartura, shlyerja e të cilave bëhet në përputhje të rregullores së Fakultetit Ekonomik. Kolegji Universitar "Logos" ka në praktikë të politikën e bursave të shumëllojshme, përmes të cilave synohet të mbështeten studentët të kategorive të ndryshme. KU "Logos" inkurajon studentët të jenë pjesë e organizimit dhe menaxhimit të Institucionit dhe të kenë përfaqësim në organet drejtuese.

Transferimi i studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta vendase ose të huaja, publike ose private, për në Kolegjin Universitar "Logos", në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi ose anasjelltas, bëhet për programe të njëjta ose të ngjashme në të njëjtin cikël studimi. Transferimi i studimeve kryhet sipas rregullores specifike për transferimin e studentëve.

Zyra e Këshillimit të Karrierës pranë Kolegjit Universitar "Logos" ndjek në vazhdimësi të dhënat mbi punësimin e studentëve aktualë. Kolegji Universitar "Logos", në nivel departamenti mban të dhëna në lidhje me punësimin e të diplomuarve. Nëpërmjet zyrës së Alumnit mbahen kontakte me të diplomuarit pranë Kolegjit Universitar "Logos" dhe ata informohen për të gjitha aktivitetet që kryhen pranë institucionit.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Programin Bachelor në Menaxhim Turizmi mund ta ta ndjekin maturantët me mesatare mbi atë të VKM dhe që kanë fituar një nga diplomat e mëposhtme:

1. Maturën shtetërore;
2. Diplomën e shkollës së mesme të përgjithshme dhe të profilizuar (sistemi para Maturës Shtetërore)
3. Diplomë të shkollës së mesme profesionale
4. Diplomë studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me diplomën e maturës shtetërore.

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim konsiston në:

- Formular aplikimi
- Dy fotografi
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit
- Diplomë e noterizuar të përfundimit të programit bachelor apo nivel ekuivalent
- Lista e notave
- Dokument i pagimit të tarifës së programit të studimit
- Vetëm për studime të kryera jashtë shtetit: Ekuivalentim i Diplomës dhe listës së notave, sipas kritereve të përcaktuara nga MAS.

Studentët që paraqiten me dokumentacionin përkatës të rregullt nënshkruajnë kontratën. Ndjekja e kësaj procedure kryhet nga sekretaria mësimore.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Sipas Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar sipas viteve (b)						Totali i Studentëve të transferuar (b)	Totali (a)+(b)
			Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V	Viti VI		
2012-2013	5								5	
2013-2014	3	7.2							3	
2014-2015	2	6.0							2	
2015-2016	9	7.1							9	
2016-2017	6	7.1							6	
2017-2018	5	7.2	1					1	6	

Gjatë vizitës në Institucion, u bë verifikimi i të dhënave për regjistrimin e studentëve. Për vitin akademik 2012-2013 dhe 2013-2014, nuk u mundësua verifikimi i të dhënave për regjistrimin e studentëve për shkak të regjistrave të vjetër.

Për vitin akademik 2016-2017, në RVB janë deklaruar 6 studentë, ndërkohë që në regjistrin e të dhënave për studentët figurojnë 5 studentë ndër të cilët 1 është pa numër matkulimi.

Për vitin akademik 2017-2018, në RVB janë deklaruar 3 studentë, ndërkohë që në regjistrin e të dhënave për studentët figurojnë 6 studentë ndër të cilët 2 janë të cregjistruar.

Për vitin akademik 2018-2019, mungojnë të dhënat në regjistrin e regjistrimit të studentëve (në regjistrin që përdoret gjatë mësimdhënies janë të regjistruar 4 studentë. Sipas sekretarisë mësimore numri i të regjistruarve në këtë vit është 3 studentë dhe 1 student i transferuar pranë Kolegjit Universitar "Logos")

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Studentët që përfundojnë ciklin e studimeve Bachelor në Menaxhim Turizmi, mund të vazhdojnë ciklin e dytë të studimeve Master në Universitete private apo shtetërore në Shqipëri. Kështu, sipas informacionit që GVJ siguroi në vizitën në institucion gjatë takimit me studentët që kishin përfunduar studimet Bachelor në

Menaxhim Turizmi, por edhe takimin me stafin akademik të Departamentit të Menaxhim Turizmi, një pjesë e mirë e studentëve, kanë vazhduar studimet master për Guidë Turistike.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Nga të dhënat e siguruar për periudhën 2011-2018, numri i studentëve të diplomuar në Kolegjin Universitar “Logos” në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi dhe që janë të punësuar është 11 studentë.

Numri total të diplomuarve

Për periudhën 2011-2018, numri i të diplomuarve në Kolegjin Universitar “Logos” në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është 16 studentë.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Nga të dhënat e siguruar nga RVB për periudhën 2011-2018, numri i studentëve të diplomuar në Kolegjin Universitar “Logos” në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi dhe që janë të punësuar në përputhje me diplomën është 5 studentë.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Nga të dhënat e siguruar për periudhën 2011-2018, numri i studentëve të diplomuar në Kolegjin Universitar “Logos” në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi dhe që janë të punësuar jo në përputhje me diplomën është 6 studentë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimit në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Menaxhim Turizmi, bëhet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 9741 datë 21.05.2007. Çdo kandidat që ka notën mesatare mbi 6 (gjashtë) dhe plotëson një nga kriteret e mëposhtme, mund të regjistrohet në ciklin e parë të studimeve pranë Kolegjit Universitar “Logos”.</p> <p>a) që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;</p> <p>b) që zotëron një diplomë të lëshuar nga një Institucion i Arsimit të Lartë brenda vendit dhe jashtë vendit.</p> <p>c) që zotëron një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me diplomën e maturës shtetërore. Kriteri bazë për përzgjedhjen e kandidatëve që kanë mbaruar Maturën Shtetërore dhe duan të kryejnë studimet e ciklit të parë Bachelor, është nota mesatare mbi 6 (gjashtë).</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p>	<p>Në faqen zyrtare web të Kolegjit Universitar “Logos”, ka të dhëna në lidhje me të gjithë programet e studimit të ofruara nga Institucioni. Studentët e regjistruar pranë Kolegjit Universitar “Logos” mund të sigurojnë të</p>

<p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>dhënat për programin e studimit të tyre jo vetëm në faqen e web-it por edhe nga përfaqësuesit e departamentit. Sekretaria mësimore, pedagogët e lëndëve përkatëse si edhe departamentet përkatëse, informojnë studentët në lidhje me programet e studimeve, afatin e përfundimit të programit, mënyrën e organizimit të programit të lëndës dhe statusin e akreditimit të programeve.</p> <p>Detaje të hollësishme për çdo lëndë mësimore bëhet në fillimin e çdo semestri nga pedagogët përkatës të lëndëve.</p> <p>Në fund të çdo semestri, studentët, nëpërmjet një pyetësori japin vlerësimin për çdo pedagog në lidhje me mësimdhënien dhe komunikimin e tyre.</p> <p>Sipas RVB studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës, por gjatë vizitës në institucion kishte një lloj konfuzioni në raportim dhe për shkak se punonjësja dedikuar karrierës kishte pak kohë që ishte punësuar në institucion.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Kolegji Universitar “Logos”, për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi disponon të dhëna për numrin e të diplomuarve në ciklin e parë të studimit, përkatësisht për secin departament.</p> <p>Sekretaria Mësimore disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi ka patur vetëm në vitin akademik 2017-2018 2 (dy) studentë të cilët janë tërhequr (çrregjistruar) nga ky program studimi.</p> <p>Sekretaria Mësimore disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim deri në vitin akademik 2017-2018. Për vitin akademik 2018-2018, pranë sekretarive mungonin të dhënat e studentëve të regjistruar (nuk ishin hedhur të dhënat e studentëve të regjistruar në regjistrin themeltar. Ka mungesë të mbajtjes së të dhënave të studentëve nëpërmjet një sistemi online apo programi kompjuterik).</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Në takimin që në patën gjatë vizitës në institucion me studentë të cilët ishin diplomuar në programe të ndryshme studimi pranë Kolegjit Universitar “Logos”, në opinionin dhe vlerësimin e tyre u shprehën se Institucioni ka ndjekur ecurinë e tyre dhe i ka ndihmuar për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidheshin me procesin mësimor. Ata u shprehën për një frymë të mirë bashkëpunimi midis studentëve dhe stafit akademik apo edhe personelit të</p>

	<p>institucionit në zgjidhjen e problematikave të tyre gjatë viteve të studimit pranë Kolegjit Universitar “Logos”</p> <p>Institucioni, nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës si edhe departamentit përkatës ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale. Praktika profesionale kryhet në vitin e tretë, në semestrin e dytë përkatësisht një ditë të javës për 15 javë. Një pedagog i departamentit kryen kontrollin përkatës për mbarëvajtjen e praktikës profesionale. Në fund të praktikës profesionale, studentët dorëzojnë një relacion në përputhje me programin e praktikës profesionale të miratuar nga departamenti. Për relacionin e praktikës studentët vlerësohen më notë nga 4 (katë) deri në 10 (dhjetë)</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Duke u bazuar tek RVB por edhe nga intervistat që ne patëm gjatë vizitës në institucion me stafin akademik, sekretarinë mësimore por vecanërisht me studentët konkludojmë se :

Kolegji Universitar “Logos”, vepron në përputhje me kriteret e vendosura në lidhje me informimin dhe përkujdesjen ndaj studentëve.

Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve dhe angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Mundësia për të komunikuar dhe për tu ardhur në ndihmë studentëve për problemet e tyre në lidhje me mësimdhënien, praktikën profesionale apo këshillimin e karrierës favorizohet edhe nga numri i vogël i studentëve që ndjekin programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi.

GVJ rekomandon se Kolegji Universitar “Logos” duhet të tregojë më shumë kujdes në mbajtjen e të dhënave për studentët.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kolegji Universitar “Logos” është një institucion i arsimit të lartë, i orientuar nga mësimdhënia dhe kërkimi shkencor. Kolegji Universitar “Logos” inkurajon të gjithë anëtarët e stafit akademik për të qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ofruar mbështetje financiare për ta për pjesëmarrjen në konferenca dhe veprimtari shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Për vitin akademik 2018-2019, institucioni ka vënë në dispozicion të secilit departament një fond prej 600 Euro, që mund të përdoren nga anëtarët e departamenteve përkatëse për pjesëmarrje në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Në të njëjtën kohë, organizimi ose bashkë organizimi i konferencave dhe i veprimtarive shkencore të një niveli ndërkombëtar është një tjetër dimension i rëndësishëm i politikës kërkimore të Kolegjit Universitar “Logos”. Çdo vit Kolegji Universitar “Logos” organizon një Konferencë Ndërkombëtare e cila mbulon fushat e veprimtarisë akademike të Kolegjit Universitar “Logos” (Shkencat Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor, Shkencat Mjekësore, Shkencat e Aplikuara (IT) dhe Shkencat Ekonomike. Në bashkëpunim me Universitetin “Zoja e Këshillit të Mirë”, Universiteti i Pireut, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Universiteti i Maltës “Universitas Sancti Cyrilli” dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës, Kolegji Universitar “Logos” realizon gjatë

vitit akademik aktivitete në kërkimin shkencor dhe leksione të hapura, simpoziume, workshop-e, si dhe aktivitete ekstrakurrikulare me tema dhe të ftuar në shërbim të profileve të programeve që implementon, Departamentet përkatëse të Kolegjit Universitar "Logos" disponojnë një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të Departamentit të Menaxhim Turizmi të angazhuar në këtë program studimi;

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 17 ne aneks)

KU Logos për vitin akademik 2017-2018 nxiti veprimtarinë kërkimore shkencore në dy forma :

1- Organizimin e aktiviteteve shkencore nga vetë institucioni si: konferenca, trajnime, botime në revistën shkencore Logos;

2- Në nxitjen e pjesmarrjes së stafit akademik në veprimtaritë shkencore të organizuar nga IAL të tjerë, qeveria apo organizata ndërkombëtare përmes rreferimeve, pjesmarrjeve si trajner, aplikimeve apo zhvillimit të projekteve.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Që nga themelimi i Kolegjit Universitar "Logos", një ndër objektivat e saj ka qenë promovimi kombëtar, si edhe vendosja e marrëdhënieve të ngushta me institucionet e arsimit të lartë në vend, rajon dhe më gjerë. Marrëdhënie bashkëpunimi janë vendosur edhe me organizata jofitimprurëse, shoqëri tregëtare etj ku prioriteti kryesor ka qenë mundësimi e praktikës profesionale të studentëve.

Kolegji Universitar "Logos" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me:

- Institucione të arsimit të lartë në vend dhe jashtë vendit: Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin "Zonja e Këshillit të Mirë". Universitetin e Pireut, Universitetin Sancti Cyrrilli A.D 1669, Maltë, Universitetin e Maqedonisë Perendimore të Greqisë, Universitetin Oradea, Rumani. Institucioni është në konkretizimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me Frederick University të Qipros
- Organizata profesionale: Shoqata Kombëtare e Turizmit
- Komuniteti i biznesit: Bashkinë e Tiranës, Tirana International Hotel & Conference Center, Hotel Mondial, me zyrën e "Financë Partners", studio kontabiliteti "Shembitraku", Bankën Kombëtare Greke (NBG), Intersig Viena Group sh.a, Telecom Albania, Kompania e Biznesit Neranxi, Alumil Albania.

Kolegji Universitar "Logos" ka marrëveshje bashkëpunimi me kompanitë dhe institucionet e lartpërmendura për kryerjen e praktikës profesionale të studentëve pranë tyre. Ndërkohë marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë në vend janë në kuadër të mësimdhënies të stafit të këtyre institucioneve pranë Kolegjit Universitar "Logos", si edhe në kuadër të organizimit të konferencës të përvitshme që organizohet pranë Kolegjit Universitar "Logos". Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit janë bërë në kuadër të trajnimit të stafit akademik të Kolegjit Universitar "Logos", sikurse edhe mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve.

Gjatë vizitës në Institucion, gjatë takimit të GVJ me drejtuesen e zyrës së marrëdhënieve me jashtë, u theksua se në të ardhmen synohet bashkëpunimi me Institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë për programe të shkëmbimit të studentëve dhe stafit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Bazuar në të dhënat e RVB por edhe gjatë vizitës në vend në lidhje me bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të tilla si pjesmarrës si partnerë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, leksione dhe seminare me lektorë të huaj etj, GVJ evidenton se Kolegji Universitar në vite është përpjekur për të siguruar marrëveshje bashkëpunimi. Të dhënat gjenden në Aneksë, tabela 18.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë jepen në Aneksë tabela 19.

Për kryerjen e praktikave profesionale në programet e studimit Bachelor në varësi edhe të profilit të tyre, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit. Institucioni në bashkëpunim me institucione të tjera apo kompani biznesi, organizon trajnime dhe leksione të hapura ku përfaqësues të biznesit japin ekspertizën e tyre profesionale në fushat përkatëse.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe tenton vazhdimisht me politikën që ndjek për marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes stafit akademik dhe gjithë punonjëve të tij. Departamentet bashkëpunojnë me njëri tjetrin për mbarëvajtjen e procesit mësimor sikurse edhe në aspektin e kërkimit shkencor, duke qene të gjithë bashkë organizatorë të konferencës së përvitshme ndërkombëtare që organizohet pranë Kolegjit Universitar “Logos”.</p> <p>Ndarja e detyrave dhe përgjegjësiive brenda institucionit janë të mirëpërcaktuara. Në fund të çdo viti akademik bëhet vetëvlerësimi nga vetë stafi akademik sikurse dhe vlerësimi i performancës së stafit nga përgjegjësi i departamentit apo nga dekani. Fryma e bashkëpunimit është një nga vlerat themelore të Kolegjit Universitar “Logos”.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Siç vërtetohet nga marrëveshjet institucionale të bashkëpunimit, për kryerjen e praktikave profesionale në programet e studimit Bachelor në varësi edhe të profilit të tyre, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p> <p>Institucioni në bashkëpunim me institucione të tjera apo kompani biznesi, organizon trajnime dhe leksione të hapura ku përfaqësues të biznesit japin ekspertizën e tyre profesionale në fushat përkatëse.</p> <p>Në përfundim të praktikës profesionale nga studentët merret feedback nga ana e tyre për kohën e kaluar pranë kompanive apo institucione ku ata kanë kryer praktikën profesionale.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Duke u bazuar tek RVB por edhe gjatë bisedave që patëm me stafin akademik, drejtues të departamenteve si edhe me drejtorin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë konkludojmë se:

Kolegji Universitar “Logos”, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.

Kolegji Universitar “Logos” garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda e jashtë vendit si edhe aktorët e biznesit vendas. Gjatë vizitës në Institucion, në takimin e GVJ me drejtuesen e zyrës së marrëdhënieve me jashtë, u theksua se në të ardhmen synohet bashkëpunimi me Institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë për programe të shkëmbimit të studentëve dhe stafit.

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

KU “Logos” ka plotësuar pjesërisht rekomandimet e dhëna nga KA në vendimin për akreditimin e parë.

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Partneritet dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.
2. Vendndodhje lehtësisht e arritshme dhe infrastrukturë e përshtatshme me mjedise dhe ambiente komode për studentët dhe stafin akademik.
3. Tarifa e shkollimit konkurruese kundrejt Institucioneve të tjera private në vend.
4. Ofrimi i bursave sociale dhe bursave të ekselencës.
5. Organizimi i konferencave dhe seminareve shkencore me karakter ndërkombëtar në nivel Fakulteti.
6. Komunikim dhe marrëdhënie cilësore midis stafit akademik dhe studentëve.
7. Inkurajimi dhe mbështetja e stafit akademik për publikime shkencore si edhe për pjesëmarrje në konferenca dhe projekte të ndryshme shkencore.
8. Kolegji Universitar “Logos” është e pajisur me të gjitha kushtet e nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor sa më bashkëkohor. Infrastruktura logjistike dhe IT e standarteve të larta është e gjitha në funksion të mësimdhënies dhe ecurisë së punës të stafit akademik, personelit dhe studentëve. Pajisja e ambienteve mësimore me kushte kondicionimi, smart board, projektorë, kompjuter, etj, mundësojnë një proces mësimor eficient.

b. Pika të dobëta:

1. Një pjesë e mirë e lëndëve të Turizmit nuk mbulohen nga staf akademik i kualifikuar apo me pregatitjen profesionale dhe akademike në fushën e turizmit.
2. Staf i brendshëm është i pamjaftueshëm nga pikëpamja numerike në ofrimin e këtij programi. Ky staf mbulon në masën 68% ngarkesën mësimore të këtij programi studimi.
3. Mungesa e disa lëndëve të formimit karakterizues të programit dhe shumë të rëndësishme për formimin e menaxherit, si Sjellje Organizative, Menaxhim Operacionesh, Menaxhim Projekti, Shkrim Akademik etj, bën që ky program studimi mos të përmbushë detyrimin ligjor. LAL 80/2015, Neni 86, pika 2: *Programet e studimit që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emertesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.*
4. Mungesa aktuale e një sistemi të dhënash (program softçare) për stafin dhe studentët.
5. Numër të kufizuar librash në bibliotekë, sidomos botime të viteve të fundit në fushën e Turizmit, për tu përdorur si literaturë e rekomanduar dhe ndihmëse për procesin mësimor.

c. Mundësitë:

1. Hartimi i politikave promovuese dhe motivuese nga Strukturat e Institucionit për të promovuar tek maturantët një program cilësor dhe për ti nxitur për tu regjistruar në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi.
2. Zhvillimi i sektorit të turizmit dhe vendosja e turizmit si prioritet kombëtar rrit kërkesën për specialistë në fushën e turizmit.
3. Numri në rritje i hoteleve dhe agjencive turistike në vend në vitet e fundit.
4. Marrëveshjet e bashkëpunimit me Universitetin e Pireut për mobilitet studentësh dhe stafi akademik.
5. Bashkimi i departamentit të Menaxhim Turizmi me departamentin e Menaxhimit të Biznesit (mendohet që do të bëhet për vitin akademik 2019-2020) do të ndikonte pozitivisht në menaxhimin më të mirë të burimeve njerëzore.
6. Më shumë përpjekje institucionale për t'u bërë pjesë e projekteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.

d. Pengesat:

1. Numri i madh i programeve të ofruara në universitetet publike dhe private në fusha të njëjta apo të ngjashme, kufizon mundësinë e përzgjedhjes së studentëve.
2. Ndryshimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe nënligjor të arsimit të lartë në Shqipëri.
3. Imazhi i krijuar për universitetet private në Shqipëri në përgjithësi, çënon rritjen e numrit të studentëve të rregjistruar pranë Kolegjit Universitar "Logos".
4. Mungesa e një studimi tregu në nivel kombëtar për nevojat e tregut të punës për profesionet dhe specialitetet.

Rekomandime:

1. Lëndë specifike të Turizmit të tilla si: Bazat e Turizmit, Strategji Turizmi etj. duhet të jepen nga staf akademik me pregatitjen profesionale dhe akademike në fushën e Turizmit. Gjithashtu Institucioni duhet të punojë për të bërë të mundur rritjen e numrit të personelit akadeik më kohë të plotë
2. Rishikimi I programit të studimit duke bërë përmirësime të nevojshme në shtimin e lëndëve të karakterit menaxherial.
3. Krijimi i një sistemi të dhënash në lidhje me rekrutimin e stafit, trajnimet dhe kualifikimet etj, si edhe të dhënat për studentët e regjistruar në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi.

4. Politikat e promovimit të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, duke theksuar avantazhet dhe mundësitë e punësimit në tregun e punës, si edhe të dhënat e publikuara nga Institucioni për historikun e punësimit të studentëve që kanë përfunduar programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi do të shërbenin si një mënyrë për të bindur maturantët me rezultate të larta për të ndjekur programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi.
5. Rishikimi i Planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, ku ndër të tjera të jetë synim edhe vendosja e detyrave të kursit me një numër të caktuar kreditesh do ti rrisnin vlerën programit të studimit. Kjo për ti bërë studentët më praktikë në mënyrën e të mësuarit dhe të menduarit.
6. Pasurimi i bibliotekës me libra hard copy por edhe libra online të viteve të fundit, për të gjitha disiplinat por sidomos për lëndët e karakterit turistik.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Prof. Dr. Ermira Qosja

2. Dr. Irma Shyle

SWOT ANALYSE (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS-).

STRENGTHS

1. Partnerships and cooperation agreements with home and abroad counterpart institutions.
2. Easily accessible location and convenient infrastructure with comfortable environments and facilities for students and academic staff.
3. Competitive education fee versus other Education Institutions in the country.
4. Offering social scholarships and scholarships of excellence.
5. Continuous organization of scientific conferences and seminars in the Faculty level.
6. Communication and qualitative relationship between academic staff and students.
7. Encouragement and support of academic staff for scientific publications as well as participation in conferences and various scientific projects.
8. The University College "Logos" is equipped with all the necessary conditions to develop a contemporary learning process. Logistic and IT infrastructures of high standards are all in the function of teaching and working performance of academic staff and students. The device of classroom with air conditioning conditions, smart board, projector, computer, etc., enable an efficient learning process.

WEAKNESSES

1. A good part of Tourism subjects are not covered by academic staff qualified in professional and academic training in the field of tourism.
2. The full -time staff is insufficient from the numerical point of view in providing this program. The staff realizes 68% study workload of the study program.
3. Lack of some of the subjects of the characterization of the program and very important for the manager education, such as Organizational Behavior, Operations Management, Project Management, Academic Writing etc., makes this study program to not fulfill its legal obligation. Higher Education Law 80/2015, Article 86, Point 2: Study programs offered in the same field of study, cycle and with the same denomination, must have similar content, at least 70 percent.
4. The current lack of a database system (software program) for students and staff.

5. Limited number of books in the library, especially recent publications in the field of Tourism, to be used as a recommended and auxiliary literature for the teaching process.

OPPORTUNITIES,

1. Designing promotional and motivating policies from Institution structures to promote qualified program of study to high class students to enroll in the Bachelor study program in Tourism Management.
2. The development of the tourism sector and the establishment of tourism as a national priority increases the demand for specialists in the field of tourism.
3. The growing number of hotels and travel agencies in the country in recent years.
4. Cooperation Agreements with the University of Piraeus for student mobility and Academic Staff mobility.
5. The merger of the Tourism Management Department with the Business Management Department (thought to be made for the academic year 2019-2020) would have a positive impact on better management of human resources.
6. More institutional effort to become part of local, regional and international projects.

THREATS

1. The large number of programs offered in public and private universities in the same or similar fields limits the choice of students.
2. Continuous change of the legal and sub-legal framework of higher education in Albania.
3. The image created for private universities in Albania in general, hinders the increase in the number of students enrolled at the University College "Logos".
4. Lack of a national market study for labor market needs for professions and specialties.

Recommendations

1. Specific Tourism Subjects such as: Principles of Tourism, Tourism Strategy, etc. should be instructed by academic staff with professional and academic training in the field of Tourism. The institution should also enable to increase the number of the full-time academic staff.
2. Review of the study program making the necessary improvements to increase the number of subjects with managerial character
3. Creating a database system for staff recruitment, training and qualifications, etc., as well as for students enrolled in the study program Bachelor in Tourism Management.
4. Promotion policies of the Bachelor in Tourism Management program, highlighting the advantages and opportunities of employment in the labor market, as well as the data published by the Institution on the employment history of students who have completed the Bachelor in Tourism Management would serve as a way to convince high school students with high scores to enrolled in the study program, Bachelor in Tourism Management.
5. Review of the study program of the Bachelor in Tourism Management, which among other things would be to set course assignments with a certain number of credits would increase the value of the study program. This is to make students more practical in the way of learning and thinking.
6. Enriching the library with hard copy books, but also online books of recent years, for all disciplines but especially for the subjects of tourism.

